



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 187

Tiranë – E martë, 24 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.10.2017	Për lirim nga detyra..... 9223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 585, datë 18.10.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH) 9223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 586, datë 18.10.2017	Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë..... 9223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 587, datë 18.10.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Kontrollin e Lartë të Shtetit..... 9225
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 18.10.2017	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Cirkut Kombëtar..... 9225
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 590, datë 18.10.2017	Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit..... 9225
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 591, datë 18.10.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 807, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore” 9226
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 18.10.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” 9226
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 593, datë 18.10.2017	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Fabio Kola..... 9227

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 594, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi”, rruga automobilistike “Pasho Hysi””, në Bashkinë e Skraparit.....	9227
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 595, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim blloqe banimi, Zogu I, krahu i djathtë (Zyra e punës, Drejtoria e Bujqësisë)”, në Bashkinë e Shkodrës.....	9228
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 596, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i fasadave të pallateve në shëtitoren “Miqësia” dhe rrugës së tregut, si dhe rehabilitimi i zonës pas pallateve të ish-mapos”, Poliçan.....	9229
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i shkollës së mesme të përgjithshme “18 Tetori”, Lushnjë”	9230
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rivitalizimi i pjesshëm pranë rrugës pedonale “Abaz Bej Lushnja”, Lushnjë”	9231
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës industriale (tregu), Pogradec”.....	9232
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 18.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i shëtitores “Republika””, Patos.....	9235
Urdhër i Kuvendit nr. 2, datë 23.10.2017	Për delegimin e kompetencave.....	9238

**VENDIM****Nr. 575, datë 10.10.2017****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Erisa Xhixho, zëvendësministër i Integritetit Evropian, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 585, datë 18.10.2017**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN
NË DETYRË TË DREJTORIT
TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
TELEGRAFIKE SHQIPTARE (ATSH)**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2 dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gëzim Podgorica, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Armela Krasniqi emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM**Nr. 586, datë 18.10.2017**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT
TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E FINANCIVE
DHE EKONOMISË, DHE BANKËS
EVROPIANE TË INVESTIMEVE,
PËR ASISTENCËN TEKNIKE
PËR PROJEKTIN E RRUGËVE
DYTËSORE DHE LOKALE NR. 2 –
MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN
DHE QËNDRUESHMËRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



Dërguar me DHL

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4.
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të z. Arben Ahmetaj, ministër i Financave

Luksemburg, 28 shkurt 2017
JU/OPS/SEE/BC/md n.

Lënda: Marrëveshje financimi për asistencën teknike për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale nr. 2 – Mbështetje për zbatimin dhe qëndrueshmërinë, e lidhur nga dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, më 4 shtator 2013, më pas e ndryshuar (**Marrëveshje Financimi**) Amendimi i Marrëveshjes së Financimit

Të nderuar zotërinj,
Shkresa i referohet:

- i) Marrëveshjes së Financimit të përcaktuar më lart;
- ii) Shkresës suaj të datës 20 dhjetor 2016.

1. INTERPRETIMI

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, termat me shkronja kapitale në këtë shkresë kanë të njëjtin kuptim siç u atribuohet atyre në Marrëveshjen e Financimit. Referimet që u bëhen neneve në këtë shkresë janë referime të neneve në Marrëveshjen e Financimit.

Në këtë shkresë:

“Data e hyrjes në fuqi” nënkupton datën në të cilën Banka i konfirmon Përfituesit me shkrim (duke përfshirë me postë elektronike apo mjete të tjera elektronike) se Banka ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, dy (2) kopje origjinale të kësaj shkrese të bashkënenshkruara sipas rregullave në emër të Përfituesit, së bashku me një kopje të vërtetuar të autoritetit përkatës të nënshkruarve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. AMENDIME TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT

Me hyrjen në fuqi në datën e hyrjes në fuqi, Marrëveshja e Financimit ndryshohet siç përcaktohet më poshtë:

Faqe | 9224

Neni 1.02

Paragrafi i dytë në nenin 1.01 ndryshohet dhe formulohet si në vijim:

“Banka do të kryejë disbursimin e grantit deri në 5 transhe (secili do të jetë një “**Transh**”). Shuma e Transhit të parë do të jetë 400,000 euro. Shuma e secilit Transh pasues, me përjashtim të dy transheve të fundit, do të jetë minimumi 200,000 euro. Përfituesi, mund t’i paraqesë herë pas here Bankës, nëpërmjet ADF-së, deri më 31 dhjetor 2017 apo ndonjë datë tjetër të miratuar nga Banka, një kërkesë për disbursim (**Kërkesë disbursimi**), kryesisht në formën e bashkëlidhur kësaj shkrese si skeduli B”.

Ndryshime të skedulit A – Përshkrimi teknik

Paragrafi 4 në skedulit A ndryshohet dhe formulohet si në vijim:

“4. Data e përfundimit për përdorimin e grantit është 31 dhjetor 2017.”

3. VAZHDIMI I DETYRIMEVE

Dispozitat e Marrëveshjes së Financimit, përveç rasteve kur ndryshohen sipas kësaj shkrese, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë. Përfituesi pranon dhe bie dakord se, përveç siç është përcaktuar dhe rënë dakord përmes kësaj shkrese, kjo shkresë nuk përbën heqjen dorë të miratuar nga Banka apo ndryshim të ndonjë kushti tjetër të Marrëveshjes së Financimit. Banka rezervon të gjitha të drejtat kontraktuale dhe ligjore që ka sipas Marrëveshjes së Financimit dhe ligjit në fuqi.

Përfituesi do të kryejë, me kërkesën e Bankës dhe shpenzimet e veta, të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm apo të dëshirueshëm për t’i dhënë fuqi ligjore ndryshimeve të kryera ose që do të kryhen sipas kësaj shkrese.

4. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI

Kjo shkresë rregullohet sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe palët e përfshira janë subjekt i juridiksionit të Tribunal d’Arrondissement (Gjykatës së Rrethit) të Luksemburgut.

Nëse pajtoheni me sa më lart, ju lutemi dërgoni dy (2) kopje origjinale të kësaj shkrese për Bankën, në vëmendje të z. Branko Cevriz (tel: +352 4379 82545, email: b.cevriz@eib.org), të nënshkruara në çdo faqe, me datë dhe të nënshkruara në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Financave në cilësinë e Përfituesit sipas Marrëveshjes së Financimit, së bashku me një kopje të vërtetuar të autoritetit



përkatës të nënshkruesve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, *jo më vonë se data 15 prill 2017*. Pas kësaj date, Banka rezervon të drejtën, me diskrecionin e saj, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Përfituesit, që të konfirmojë nëse pranimi i kësaj shkrese nga Përfituesi konsiderohet i dhënë në mënyrë të vlefshme nga Përfituesi.

Me respekt,
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Massimo Novo Jean-Marc Arnoux

(Nënshkrimi) (Nënshkrimi)

Pranuar dhe rënë dakord për dhe në emër të:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga ministri i Financave,
si Përfituesi

Z. Arben Ahmetaj, ministër i Financave

Datë 13 prill 2017

VENDIM
Nr. 587, datë 18.10.2017

PËR NJË SHITESË FONDI
NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR
PËR KONTROLLIN E LARTË
TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrollit të Lartë të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 11 700 000 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekësh, zëri “Shpenzime kapitale, me financim të brendshëm”, për projektin “Rikonstruksion godine i KLSH-së”.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 589, datë 18.10.2017

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Sajmir Çili emërohet drejtor i Cirkut Kombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 590, datë 18.10.2017

PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Ujit, si organ qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrin e Brendshëm;



- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë me delegim, në vend të tij merr pjesë zëvendëskryeministri, me të drejtë vote.

3. Vendimi nr. 1080, datë 18.12.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen anëtarët e Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 591, datë 18.10.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 807, DATË 16.11.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISIPLINIMIN E ANGAZHIMEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, 40 dhe 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “dh”, të pikës 3, të vendimit nr. 807, datë 16.12.2016, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“ e) fondet e shpërndara me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin 2017.”.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 592, datë 18.10.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 955, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 e 6, 20, pika 2, dhe 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Anëtarët madhorë të familjes paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike.”.

2. Në pikën 9 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes ...” shtohen “... që jetojnë në të njëjtën strehë ...”.

b) Në shkronjën “b”, fjalët “... brenda një afati 10-ditor ...” zëvendësohen me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ...”.

c) Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim.”.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2018.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**VENDIM****Nr. 593, datë 18.10.2017****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË FËMIJËS FABIO KOLA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Fabio Kola, në masën 4 000 000 (katër milionë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM**Nr. 594, datë 18.10.2017**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIMI I HAPËSIRAVE
PËRRETH PALLATIT TË KULTURËS,
RRUGA ME TRAFIK TË KUFIZUAR/
PEDONALJA “PASHO HYSI”, RRUGA
AUTOMOBILISTIKE “PASHO HYSI””,
NË BASHKINË E SKRAPARIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi”, rruga automobilistike “Pasho Hysi””, në Bashkinë e Skraparit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Skraparit.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “ndërtesë”, me sipërfaqe 15 (pesëmbëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 653 703 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 653 703 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Skraparit, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Skraparit.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Skraparit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.



8. Regjistrimi i ri i pasurisë “ndërtesë”, me sipërfaqe 15 (pesëmbëdhjetë) m², për projektin “Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi”, rruga automobilistike “Pasho Hysi”, të bëhet në favor të Bashkisë së Skraparit.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar dhe Bashkia e Skraparit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIM I HAPËSIRAVE PËRRETH PALLATIT TË KULTURËS, RRUGA ME TRAFIK TË KUFIZUAR/PEDONALJA “PASHO HYSI”, RRUGA AUTOMOBILISTIKE “PASHO HYSI””

Bashkia Skrapar

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e ndërt./m ²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera e përgjithshme/lekë	Lloji i dokumentit
1	Fatmira Tahir Xhizdari	1420	4/154	15	43 580	653 703	Vërtetim pronësie
TOTALI						653 703	

VENDIM

Nr. 595, datë 18.10.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “SISTEMIM BLOQE BANIMI, ZOGU I, KRAHU I DJATHTË (ZYRA E PUNËS, DREJTORIA E BUJQËSISË)”, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim blloqe banimi, Zogu I, krahu i djathtë (Zyra e punës, Drejtoria e Bujqësisë)”, në Bashkinë e Shkodrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i

bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë “ndërtesë”, me sipërfaqe 10 (dhjetë) m², dhe “truall”, me sipërfaqe prej 10 (dhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 411 580 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 411 580 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Shkodër, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Shkodër.

5. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Shkodër, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 10 (dhjetë) m² “ndërtesë” dhe 10 (dhjetë) m² “truall”, për projektin “Sistemim blloqe banimi, Zogu I, krahu i djathtë (Zyra e punës, Drejtoria e Bujqësisë)”, të bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTIT “SISTEMIM BLOQE BANIMI, ZOGU I, KRAHU I DJATHTË
(ZYRA E PUNËS, DREJTORIA E BUJQËSISË)

Bashkia Shkodër

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit/m ²	Çmimi i truallit/lekë	Vlera në lekë	Sip. e ndërt./m ²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera në lekë	Vlera e përgjithshme/lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Pjerin Paloka	8591	1/856	10	8511	85 110	10	32648	326 480	411 590	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	TOTALI									411 590	

VENDIM

Nr. 596, datë 18.10.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIMI I FASADAVE TË PALLATEVE NË SHËTITOREN “MIQËSIA” DHE RRUGËS SË TREGUT, SI DHE REHABILITIMI I ZONËS PAS PALLATEVE TË ISH-MAPOS”, POLIÇAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i fasadave të pallateve në shëtitoren “Miqësia” dhe rrugës së tregut, si dhe rehabilitimi i zonës pas pallateve të ish-mapos”, Poliçan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Poliçan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 130 543 (nëntë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 130 543 (nëntë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Poliçan.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Poliçan.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Poliçan, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar dhe Bashkia Poliçan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



TABELA E VLERAVE TË OBJEKTEVE PËR EFEKTIN E SHPRONËSIMIT
PËR INTERES PUBLIK

Llogaritjet janë kryer duke u mbështetur në:

Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”;

Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;

VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

VKM-në nr. 401, datë 23.10.1989, “Për miratimin e normave të reja të amortizimit”

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i objektit	Sipërfaqe truall (m ²)	Sipërfaqe ndërtimi (m ²)	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera truall	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera truall dhe ndërtësë	Konfirmimi nga ZVRPP-ja Skrapar
1	Engellush Hysko	3019	12/185	Garazhd	83	83	539	44737	551,830	596,567	Po
2	Enver Lulaj	3019	12/199	Lokal	109	109	539	58751	2,006,044	2,064,795	Po
3	Enver Lulaj	3019	12/227	Garazhd	35	35	539	18865	602,564	621,429	Po
4	Safet Kacani	3019	12/197	Dyqan	0	30	539	0	749,738	749,738	Po
5	Mimoza Ylli Elona Sako Ylli Delian Sako Ylli	3019	12/193	Lokal	0	30	539	0	1,035,367	1,035,367	Po Po Po
6	Kastriot Murati	3019	12/66	Dyqan	0	40	539	0	927,125	927,125	Po
7	Hamza Elezi	3019	12/67	Garazhd	20	20	539	10780	312,840	323,620	po
8	Haredin Muço	3019	12/25	Dyqan	20	20	539	10780	326,537	337,317	Po
9	Lulezim Saliasi	3019	12/26	Garazhd	0	38	539	0	347,048	347,048	Po
10	Fatbardh Xhamallati	3019	12/27	Godine	0	60	539	0	744,950	744,950	Po
11	Hatem Kurti	3019	12/30	Godine	0	38	539	0	728,327	728,327	Po
12	Shaqir Kaja	3019		Dyqan	0	15	539	0	193,430	193,430	Mungesë dokumentacioni
13	Nuhu Brahimasi	3019	12/190	Godine	0	49	539	0	390,760	390,760	Mungesë dokumentacioni
14	Xhuljeta Zyla	3019	12/190	truall	130	0	539	70070		70,070	Po
								213983	8,916,560	9,130,543	
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMEVE											
										9,130,543	

VENDIM

Nr. 597, datë 18.10.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME “18 TETORI”, LUSHNJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë

private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i shkollës së mesme të përgjithshme “18 Tetori”, Lushnjë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 92 226 (nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimin, prej 92 226 (nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt



shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në

momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VLERA E SHPRONËSIMIT TË TRUALLIT TË ZNJ. DRITA YMER GUÇE + BASHKËPRONARE,
NË LAGJEN “SKËNDER LIBOHOVA”, ZONA KADASTRALE 8572

Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	N/pasurisë	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	9/82	Drita Ymer Guçe + bashkëpronare	8572	Truall	m ²	10.3	8954	92 226
							SHUMA TOTALE	

VENDIM

Nr. 598, datë 18.10.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIVITALIZIMI I PJESSHËM PRANË RRUGËS PEDONALE “ABAZ BEJ LUSHNJA”, LUSHNJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rivitalizimi i pjesshëm pranë rrugës pedonale “Abaz Bej Lushnja”, Lushnjë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 320 397 (treqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 320 397 (treqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojnë



procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VLERA E SHPRONËSIMIT TË TRUALLIT TË Z. SHABAN DAUT BEQIRI, NË LAGJEN
“KONGRESI”, ZONA KADASTRALE 8571

Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	N/pasurisë	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	18/19	Shaban Daut Beqiri	8571	Truall	m ²	33	9709	320397
							SHUMA TOTALE	320397

VENDIM

Nr. 599, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI
I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION
I RRUGËS INDUSTRIALE (TREGU),
POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës industriale (tregu), Pogradec”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 7 665 468.5 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 665 468.5 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Pogradec.



8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së

gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS INDUSTRIALE (TREGU)”

Nr.	Emri	Pronari Atësia	Mbiemri	Zona kadas.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Sip shpron. m ²	Lloji i pasurisë	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Vlera totale lekë	Konfirmime	Shënime
1	Adriatik	Vait	Jakupllari	8581	5/265	23	23	Ndërtesë	32381	744763						Bllokuar në favor të z. G. Kancellari
2	Adriatik	Vait	Jakupllari	8581	5/266	21.5	21.5	Ndërtesë	32381	696191.5						
3	Adriatik	Vait	Jakupllari	8581	5/267	21.5	21.5	Ndërtesë	32381	696191.5						
4	Adriatik	Vait	Jakupllari	8581	5/268	21.5	21.5	Ndërtesë	32381	696191.5						
5	Adriatik	Vait	Jakupllari	8581	5/269	23	23	Ndërtesë	32381	744763						Bllokuar në favor të z. L. Kllomollari
6	Valbona	Vasil	Kacori (Kerthi)	8581	5/375-N1	23.5	23.5	Ndërtesë	32381	760953.5	10	10491	104910	865863.5		
7	Elda	Vasil	Spirollari	8581	5/375-N2	23.5	23.5	Ndërtesë	32381	760953.5	10	10491	104910	865863.5		
8	Gjergji	Vasil	Kerthi	8581	5/375-N3	64	64	Ndërtesë	32381	2072384	27	10491	283257	2355641		
										3594291				TOTAL =	7665468.5	



VENDIM
Nr. 600, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I
SHËTITORES “REPUBLIKA””, PATOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i shëtitores “Republika””, Patos.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Patos.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 49 212 840.64 (dyzet e nëntë milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet pikë gjashtëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 49 212 840.64 (dyzet e nëntë milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet pikë

gjashtëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Patos.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Patos, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Patos për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



LISTA E SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA PËR PROJEKTIN E PATOSIT

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit m ²	Sip. e prekur e truallit në m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Sip. e ndërtesës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Vlera e ndërtesës	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike
1	Panajot Rauf Levendi	2890	10/106 ^{-ND}	21	21	2,848.00	59,808.00	42.00	42.00	1,228,027.56	1,287,835.56	Vërtetim hipotekor
2	Fatos Rauf Levendi	2890	10/106 ^{-NI}	21	21	2,848.00	59,808.00	42.00	42.00	1,031,310.76	1,091,118.76	Vërtetim hipotekor
3	Shkelqim Barjam Hatija	2890	6/94			2,848.00	-	48.00	48.00	1,281,000.82	1,281,000.82	Vërtetim hipotekor
4	Faslli Mahmut Zylali	2890	10/44			2,848.00	-	36.00	72.00	1,839,628.26	1,839,628.26	Vërtetim hipotekor
5	Liri Ramis Rizaj	2890	1/45 ^{-NS}			2,848.00	-	12.00	12.00	328,181.79	328,181.79	Vërtetim hipotekor
6	Luan Mesur Mustafaraj, Natashi Avni Mustafaraj	2890	6/10	160	80	2,848.00	227,840.00	80.00	-	-	227,840.00	Vërtetim hipotekor
7	Halime Mustafaraj, Nesllie Beharaj, Gentjan Mustafaraj, Dashnor Mustafaraj	2890	10/107, 10/120, 10/121	114.7	114.7	2,848.00	326,665.60	114.70	114.70	3,842,211.02	4,168,876.62	Vërtetim hipotekor
8	Brunilda Bashkim Vrenozi	2890	1/46	30	30	2,848.00	85,440.00	30.00	30.00	1,178,583.05	1,264,023.05	Vërtetim hipotekor
9	Fatjon Nexhip Rizaj	2890	1/45 ^{-NE}	0	0	2,848.00	-	18.00	18.00	525,890.87	525,890.87	Vërtetim hipotekor
10	Ilir Sulejman Hodo	2890	10/118	40	40	2,848.00	113,920.00	71.43	71.43	1,577,044.94	1,690,964.94	Vërtetim hipotekor
11	Genci Sulejman Mehmeti	2890	1/45 ^{-ND}			2,848.00	-	82.00	82.00	2,296,000.00	2,296,000.00	Vërtetim hipotekor
12	Leonard Fejzi Gropa, Elmira Kadri Gropa	2890	2/45	3	3	2,848.00	8,544.00	-	-	-	8,544.00	Vërtetim hipotekor
13	Ylli Rrapush Isufaj, Antoneta Liu Isufaj	2890	10/104	237.5	72.54	2,848.00	206,593.92	237.50	145.08	3,559,380.03	3,765,973.95	Vërtetim hipotekor
14	Petreit Bektash Beharaj, Leonora Islam Beharaj	2890	10/21	21	21	2,848.00	59,808.00	16.00	16.00	539,831.48	599,639.48	Vërtetim hipotekor
15	Ladi Hysen Duraj	2890	10/50	42	42	2,848.00	119,616.00	32.00	32.00	690,944.73	810,560.73	Vërtetim hipotekor
16	Fatos Namik Manaj	2890	10/105	550	293	2,848.00	834,464.00	140.00	-	-	834,464.00	Vërtetim hipotekor
17	Fatos Namik Manaj	2890	6/85	46	46	2,848.00	131,008.00	35.00	35.00	522,747.05	653,755.05	Vërtetim hipotekor
18	Shpetim Sami Resuli	2890	6/52	55	55	2,848.00	156,640.00	55.00	55.00	2,388,333.16	2,544,973.16	Vërtetim hipotekor
19	Fatmir Dervish Bejko	2890	6/51	55	55	2,848.00	156,640.00	55.00	55.00	2,388,333.16	2,544,973.16	Vërtetim hipotekor
20	Islam Myslim Hazizaj	2890	6/47	100.1	100.1	2,848.00	285,084.80	74.00	74.00	2,445,542.83	2,730,627.63	Vërtetim hipotekor



21	Avdyl Qamil Lizaj	2890	8/76	48.2	48.2	2,848.00	137,273.60	48.20	48.20	916,980.55	1,054,254.15	Vërtetim hipotekor
22	Bexhet Hasim Muçaj, Odhise Thanas Pango, Enver Dyrmishi	2890	6/29	210	210	2,848.00	598,080.00	210.00	210.00	3,945,367.65	4,543,447.65	Vërtetim hipotekor
23	Vojsava Sherif Minolamaj	2890	2/44	48	48	2,848.00	136,704.00	48.00	48.00	1,746,203.91	1,882,907.91	Vërtetim hipotekor
24	Bylyre Mehmet Matohiti	2890	6/42	60	60	2,848.00	170,880.00	60.00	60.00	1,463,892.28	1,634,772.28	Vërtetim hipotekor
25	Agim Qemal Meta	2890	6/30	12.09	12.09	2,848.00	34,432.32	12.09	12.09	400,706.23	435,138.55	Vërtetim hipotekor
26	Elisabeta Zeqir Grëmbi, Agim Elmas Grëmbi	2890	10/14 ^{-N2}	14	14	2,848.00	39,872.00	14.00	14.00	454,157.47	494,029.47	Vërtetim hipotekor
27	Ferhat Sulejman Koçi	2890	8/43	45	45	2,848.00	128,160.00	30.00	30.00	1,020,970.52	1,149,130.52	Vërtetim hipotekor
28	Luto Zenel Gjellaj	2890	7/95	120	120	2,848.00	341,760.00	120.00	120.00	2,960,107.41	3,301,867.41	Vërtetim hipotekor
29	Besnik Dahri Dahriu, Anila Qazim Rrapaj	2890	8/69	71.8	71.8	2,848.00	204,486.40	71.80	52.00	1,729,215.18	1,933,701.58	Vërtetim hipotekor
30	Bardhyl Fari Osmëni	2890	8/11	19.4	19.4	2,848.00	55,251.20	19.40	19.40	362,685.88	417,937.08	Vërtetim hipotekor
31	Maliq Fejzi Gropa	2890	10/100	140	140	2,848.00	398,720.00			-	398,720.00	Vërtetim hipotekor
32	Muço Selamet Muçaj	2890	1/45 ^{-N2}	30	30	2,848.00	85,440.00	30.00	30.00	865,153.43	950,593.43	Vërtetim hipotekor
33	Nevret Sami Bregu	2890	7/101	1179	156.4	2,848.00	445,427.20			-	445,427.20	Vërtetim hipotekor
34	Vladimir Taip Shusha	2890	8/45	115.7	26.7	2,848.00	76,041.60			-	76,041.60	Vërtetim hipotekor
							-			-	-	
TOTALI										49,212,840.64		lekë

**URDHËR****Nr. 2, datë 23.10.2017****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Kuvendi i Shqipërisë, për procedurat e prokurimit publik, te z. Genci Gjonçaj, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë